



Prof. Asoc. Dr. Sc. Fadil Hasani u lind në fshatin Vërban, komuna e Bujanocit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Bujanoc. Ka mbaruar Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, drejtimi i Kimisë në Universitetin e Prishtinës.

Studimet pasdiplomike në drejtimin Kimi Analitike dhe Kimi e Mjedisit i mbaroi në vitin 2008, në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 2010 regjistroi doktoratën dhe në vitin 2013 merr gradën shkencore “Doktor i Shkencave” në Universitetin Bujqësor të Tiranës, ndërsa

hulumtimet e disertacionit i zhvilloi në Institutin për Fizikë Bërthamore të Zbatuar në Tiranë, nën udhëheqjen e Prof. Dr. Kostandin Dollani, me temë “Vlerësimi i Ndotjes Mjedisore Radioaktive”.

Nga viti akademik 2011/2012 është ligjërues në Kolegjin e Shkencave Mjekësore “ALMA MATER EUROPA CAMPUS - REZONANCA” në Prishtinë dhe më tutje vazhdon të punojë.

Që nga viti 2008 deri në vitin 2022 ka punuar në Zyrën e Kryeministrit, në Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore në pozitën e Inspektorit për siguri bërthamore dhe mbrojtje nga rrezatimi, me një përvojë mbi 14-vjeçare nga kjo fushë. Është ekspert për “Mbrojtje nga Rrezatimi Jonizues” i njohur nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore. Pas daljes nga Zyra e Kryeministrit, përkatësisht Agjencisë së Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore themeloi kompaninë “AlphaExpert” për mbrojtje dhe për siguri nga rrezatimet, ku drejton veprimtarinë e tij, duke kryer ekspertiza dhe trajnime në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes nga rrezatimi. Deri tani ka të botuara mbi 40 punime shkencore në revistat më prestigjioze të vendit dhe ato ndërkombëtare, si: Shqipëri, Itali, Hungari, Poloni, Rumani, Austri, Gjermani, Britani e Madhe, ShBA, Turqi etj. Në vitin 2014 ka botuar librin Universitar “RADIOKIMIA” me dy bashkautorë nga Tirana, libër i parë në gjuhën shqipe nga kjo fushë. Po ashtu në vitin 2020 botoi librin e tij të dytë Universitar me titull “RADIOAKTIVITETI-NDOTJA DHE MBROJTJA”. Ka marrë pjesë në shumë konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare. Ka realizuar dhe ka qenë pjesëmarrës i disa projekteve nga fusha e radioaktivitetit dhe mbrojtjes nga rrezatimi. Gjithashtu ka marrë pjesë në një numër të madh të trajnimeve kryesisht nga fusha e sigurisë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimi në shumë vende të botës.

ISBN 978-9951-391-13-9



9 789951 391139

Prof. Assoc. Dr. Sc. FADIL HASANI RREZATIMI NË JETËN E PËRDITSHME



ALMA MATER EUROPAEA
CAMPUS COLLEGE “REZONANCA”

FADIL HASANI

RREZATIMI NË JETËN E PËRDITSHME



PRISHTINË
2024